



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura e III-të**

Më datë 13.03.2008, në ora 11:00;  
Salla C-203;

**Komisioni për**  
Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

**Procesverbal**

Mbledhjen e drejtoi  
Myzejene Selmani – kryetare e Komisionit

**Morën pjesë:**

Et'hem Çeku, Safete Hadergjonaj, Sala Berisha-Shala, Múfera Šinik, Kaqusha Jashari, Haki Shatri, Fatmir Rexhepi dhe Zef Morina;

**Munguan:** Slobodan Petrovič dhe Berim Ramosaj;

Nga zyra mbështetëse:

Hasan Tahiri, Advie Morina dhe Armend Ademaj;

Përfaqësues të Zyrës së Rregullatorit për Energji “ZRRE”: Ali Hamiti Kryetar i Bordit të ZRRE-së, Nysret Avdiu anëtar i Bordit të ZRRE-së, Theranda Beqiri anëtare e Bordit të ZRRE –së dhe Muharrem Gashi ekspert i tarifave në ZRRE-së;

Pjesëmarrës tjerë: Vjosa Bajraliu nga NDI-ja;

**Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi i Raportit Konsultativ të Zyrës së Rregullatorit për Energji, lidhur më tarifatat të energjis elektrike 2008;
2. Të ndryshme;

**- Rendi i ditës u miratua.**

**3. II - Shqyrtimi i Raportit Konsultativ të Zyrës së Rregullatorit për Energji, lidhur më tarifat të energjise elektrike 2008;**

**Kryetarja** – pasiqe e hapi mbledhjen ftoj për paraqitje të Raportit Konsultativ lidhur me tarifat e energjise elektrike 2008, z. Ali Hamiti Kryetar i Bordit të ZRRE-së;

**Ali Hamiti (Kryetar i Bordit të ZRRE-së)** – pasi përshëndeti anëtarët e Komisionit, theksoj që është obligim i ZRRE-së që të pasqyroj Raportin Konsultativ për tarifat e energjisë elektrike 2008. Më tej shtoj se KEK-u dhe KOSST-i kanë paraqitur kërkesat e tyre të hyrat lejuara për vitin 2008, dhe tash ata kanë bërë sqarime të ndryshme në paraqitje të tyre dhe në raportin e tyre preliminar në kemi bërë një raport konsultativ pas një analize të kërkesave të tyre, shumë të detajuar. Në këtë raport i kemi dhënë kërkesat e tyre lidhur me ato propozime që i kanë paraparë ato dy kompani. Është obligim i KEK-ut që ata ta bëjnë këtë kërkesë të tyre të hyrave të lejuara dhe ta paraqesin një strukturë të tarifave më të përshtatshme për të mbledhur të hyrat e tyre nga shitja e energjisë të cilat ua dërgojnë konsumatorëve. KEK-u dhe KOSST-i janë ndërmarrje publike ku veprimtaria e tyre rregullohet nga ZRRE-ja. Në i kemi marr ato aplikacione i kemi shqyrtuar dhe i kemi futur me një plan për propozim për diskutim dhe sot kemi ardhur këtu që tua paraqesim juve si Komision parlamentar si dhe palëve të interesuara. Kërkesat e KOSST-it janë si shpenzime të KEK-ut, ato në esencë janë ngarkesë për KEK-un andaj në fund të fundit këtë e paguan konsumatori, transportin e paguan konsumatori, transport me shumicë është KOSST-i, ndërsa transport me pakicë është shpërndarja ose distribucioni. Për sivjet KEK-u është propozuar të hyrat e lejuara ku ju i keni të pasqyruara në tabelën 1 që ju kemi dorëzuar në raport. Kështu që këtu hyjnë të gjitha shpenzimet për prodhimin dhe distribuimin e energjisë elektrike për konsumatorin. Më poshtë në tabelën tjetër i keni subvencionet e importit që i ka siguruar qeveria për vitin 2007, ndërsa sivjet ka dhënë një subvencion prej 19.8 milion euro, dhe për raste sociale 4.5 milion euro, si subvencion për KEK-un. Ashtu parashihet një eksport prej 1.4 milion euro dhe shitje konsumatorëve 19.6 milion euro. Pra këto janë ato shifra që përcaktojnë tarifat e energjisë, ku siç e shikoni për vitin 2008, KEK- u pritët që prej konsumatorëve të marr 136.8 milion euro, kjo është shifra që KEK-u duhet të arkëtoj prej konsumatorëve, andaj në bazë të këtyre shifrave pritët një rritje prej 10 % të tarifave. Ndërkaq zyra jonë pas analizës dhe renditjes së shpenzimeve ka ardh në përfundim se KEK-u dhe KOSST-i mund të punojnë me 135 milion euro si shpenzime të lejuara të cilat mund ti mbledhin nga konsumatorët. Propozimet e KEK-ut mund ti shikoni në tabelën 3 në faqen 10, andaj është një propozim që të këtë një rritje prej 5 % së tarifës së energjisë. Ju e dini historinë e vitit të kaluar dhe pas propozimeve janë kthyer ato propozime dhe kanë ngelur disa pune pa përfunduar. Kështu që KEK-u ka inkuar vetëm 38 milion euro që nuk e kanë arritur as për së afërmi përmbushjen e planifikimit që ka qenë. Sivjet ato projekte që nuk janë të financuara në nuk i kemi marr ti fusim në tarifa për shkak se jam i bindur se ata nuk kanë ku ti marrin ato të holla. Është një grand i qeverisë prej 38 milion për projekte kapitale dhe një dhuratë prej 79 milion për projekte

tjera kapitale kështu që mbulohen gati shumica e projekteve kapitale me këto grande, kanë mbetur edhe 20 milion euro të pa mbuluara. Prioritet i parë është blerja e njehsorëve, sepse nuk ka gjë me strategjike se te ulen humbjet që ka KEK-u, vjedhjet nga konsumatorët, andaj alfa dhe omega për matjen e energjisë të konsumatorit të cilën e shfrytëzon. Në baze të matjeve që kemi bërë 48% KEK-u ka pasur humbje vitin e kaluar. Ndërsa parashikimet tona kane qenë afërsisht rreth 35 %. Ndërsa sivjet kane ardh me kërkesë që parashihen humbje rreth 40%. Përderisa nuk ndërmarrin masa gjithëpërfshirëse jo vetëm nga KEK-u por nga të gjitha subjektet shtetërore ne vend, sepse nuk mund të mbulohen këto humbje komerciale, ku realisht janë 48 % humbje. Ne nuk llogarisim që KEK-u ka me i mbledh të gjitha të hyrat sepse edhe në vendet më të civilizuar inkasohen shkon deri në 95 % d.m.th që nuk arrihet 100% i inkasimit. Andaj në bazë të këtyre llogaritjeve del se 52% është faturuar ndërsa nuk faturohet 48% e energjisë elektrike. Rritjen e shohim kryesisht nga importi sepse është planifikuar krejt më një çmim tjetër megjithatë tenderët që i ka shpall KEK-u nuk ka arritur që të siguroj energjinë me atë mesatare që iu ka lejua, pra ka qenë 74 euro për megavat/orë ndërsa ka shkuar më vonë çmimi deri ne 104 euro për megavat/orë, andaj kjo është një shifër që e ka rëndu humbjen e KEK-ut. Në fund të prezantimit theksoj që këtu ka ardh më bashkëpunëtorët e tij në qoftë se anëtarët e Komisionit kanë diçka specifike për tu sqaruar.

**Et'hem Çeku** – pasi që filloj diskutimin e tij falënderoj prof. Ali Hamitin për prezantimin e tij, lidhur me tarifën e energjisë elektrike 2008, duke theksuar se e njeh mirë problematiken që ekziston në sektorin e energjisë pasi që ishte në mandatin e kaluar ministër i MEM-it. Mirëpo është me rëndësi që qeveria ta sheh me seriozitet punën e KEK-ut, që ka të bëjë me furnizimin e qytetarëve me energjinë elektrike. Vitin e kaluar kemi pas dallime ku ne si ministri e kemi mbështet ngritjen e tarifës së energjisë mirëpo ne konsulta të vazhdueshme me mekanizma ndërkombëtar, kryesisht me USAID-in pasi që kjo organizatë ka bërë mjaft hulumtime dhe e ka njoftua mirë situatën energjike në Kosovë, ndërsa qëndrimi i qeverisë ka qenë që nuk mund të ngritën tarifën. Andaj atëherë është dashur që të gjinden mjetet financiare për ti mbuluar shpenzimet. Pra përvoja ka qenë mjaft e vështirë sepse presioni ka qenë mjaft i madh por nuk e dinin ata se çfarë gjendje ishte në KEK. Pra ne tani duhet të merremi vesh me qeverinë së çfarë strategjie dëshiron të përcjell d.m.th a do ti mbulon shpenzimet e KEK-ut, duke e mbështetur me donacione apo do ti rrit tarifën, këto dy rrugë janë. Prandaj është mirë që ZRRE –ja e ka sjell një material të mirë për shqyrtim dhe unë jam i pajtimit që ti harmonizojmë qëndrimet me qeverinë sepse pa i mbuluar humbjet teknike të KEK-ut, nuk mund të këtë investime. Në fund z. Çeku theksoj se është mirë që mos ta politizojmë situatën me energjinë sepse deri me tani ka qenë e politizuar dhe unë kam një përvojë të hidhur nga koha kur kam qenë ministër, mirëpo unë nuk jam që të vazhdohet më atë avaz që ka mbizotërua kështu që unë jam për shqyrtimin e tarifave që është sjell nga ana e ZRRE-së.

**Nysret Avdiu (anëtar i Bordit të ZRRE-së)** – theksoj që kemi edhe komentet e Zyrave të huaja ku vërejtjet kryesore janë që ne nuk duhet të shkojmë në tarifë sociale, është gjithashtu e lidhur edhe në investimet në sektor në nxitjet në kapitalit privat në kapaciteteve të reja energjetike drejtpërsëdrejti në mënyrën e arkëtimit se sa behet në

Kosovë andaj e zvogëlon mundësinë e investimit në këtë sektor duke marr parasysh pra arkëtimin e dobët që behet. Kështu qe ne kemi ardh në përfundim që të shkohet në ngritje të tarifave në mënyrë që t'i arrijmë objektivat e investimeve dhe shpenzimet e prodhimit.

**Et'hem Çeku** – theksoj që çështja e tarifave është e lidhur direkt me çështjen e investitorëve sepse është mjaft e vështirë që të arrihet thithja e investimeve pasi qe nuk arrihet inkasimi sepse me pothuajse 50% të këtij inkasimi i rrezikohet kostoja e investimit secilit investitor. Konsideroj që ne duhet të largohemi nga koncepti social i politikave sociale të furnizimit, përveç disa kategorive të caktuara.

**Kryetarja** – pyeti përfaqësuesit e ZRRE-së së qfar politike duhet të përcjell qeveria e Kosovës që të gjithë konsumatorët të kyqen në pagesën e rrymës, sepse ka një disbalanc në mes të konsumatorit që e paguan energjinë dhe atyre që nuk e paguan pothuajse fare, edhe pse dihet që nuk mund të arrihet inkasimi 100% por se paku të shkohet deri ne 70 apo 75%? Mirëpo kerkoj edhe nga anëtarët e Komisionit që të gjithë mund të deklarohen apo të pyesin lidhur me këtë qështje pastaj të marrin përgjegje nga të përfaqësuesit e ZRRE-së.

**Safete Hadergjonaj** – në diskutimin e saj pohoj që është në plan veprimin e Komisionit tonë që të merremi me këtë problematik dhe falënderoj përfaqësuesit e ZRRE-së për prezantimin e tyre këtu para Komisionit. Në pyetjen e saj për përfaqësuesit e ZRRE-së shtroj si më poshtë: se çfarë të behet me ato kategori që nuk po e paguajnë rrymën, çfarë politikave do të ndjekin; sa është ndikimi i ZRRE-së në këtë drejtim; Ndërsa krejt në fund theksoj që me rritjen e tarifave absolutisht nuk pajtohem mirëpo nëse arsyetohet në forma të detajuar mirë për disa kategori të caktuara sidomos për ata shpenzuese të mëdhenj do të ishte mirë të rishikohet rritja e tarifave për këtë kategori.

**Haki Shatri** – theksoj që ta kemi të qartë rolin e ZRRE-së dhe kompetencat e KEK-ut dhe mos ti ngatërrojë sepse i kane përgjegjësitë e ndara dhe problemet e ndara. ZRRE-ja ka ardh me një propozim dhe normalisht e mbështes në gjendjen faktike dhe në rrethana konkrete. Unë e arsyetoj propozimin e ZRRE-së për lëvizjen e tarifave sepse e kam pas këtë qëndrim edhe vitin e kaluar dhe e kam edhe sot sepse kam qenë i kyçin në këtë problematikë edhe pse qëndrojnë ato që thuhet këtu që do të ngarkohet konsumatori i pagesës së rregullt por në qofte se nuk e mbështesim këtë propozim në do ta keqësojmë edhe me shume situatën me energji, po ashtu edhe konsumatori i rregullt prapë do të këtë furnizim të dobët.

**Kaqusha Jashari** – në deklarinimin e saj pohoj që KEK-u edhe në sistemin e kaluar politik ka pasur probleme të shumta mirëpo janë përballu sepse kanë qenë rrethana tjera atëherë dhe theksoj që edhe unë jam kundër asaj që të këtë tarifa sociale sepse e pengon situatën e zhvillimit por nuk e pranoj rritjen e tarifave elektrike, dhe kërkoj që të behet punë më e mirë në lidhje me menaxhimin e KEK-ut, aty mendoj që ekziston problemi ku janë burimet dhe gabimet të evidentohen saktë. Pra kategorish jam për mos me përkrah propozimin e ZRRE-së për rritje të tarifave të energjisë elektrike, tha ajo në fund të diskutimit.

**Fatmir Rexhepi** – u pajtua më parafolësit që të këtë harmonizim të politikave në sektorin e energjisë në vija të trasha. Kështu që ne si Komision parlamentar duhet ti sugjerojmë qeverisë që të vazhdoj më një dinamik krejt tjetër dhe në investimet kapitale, borxhet e KEK-ut, të paraqes politika që ti ndihmohet në mënyrë që në të ardhmen KEK-u të jetë në gjendje ti përballoj vetë investimet dhe ta rrit inkasimin në bazë të punës dhe afarizmit të tij. Kur jemi të politika e çmimeve unë e përkrahu propozimin e ZRRE-së për rritjen e tarifave të energjisë për vitin 2008 sepse deri me sot jemi treguar të pafuqishëm në këtë sferë d.m.th që nuk kemi mundur as ta ngrinin e as ta ulim çmimin e energjisë, ku kujtoj që kjo ngritje prej 5% nuk është një ngritje e madhe dhe e përjashton atë kategorinë që shfrytëzon 200 KW.

**Zef Morina** – në fillim theksoj që kjo gjendje jo e mirë e furnizimit, dhe ky propozim për ngritje e çmimit të energjisë mendoj që vetëm sa do ta rëndon edhe më shumë këtë situatë andaj duhet të jemi të kujdesshëm në veprimet që do të ndërmerren. Ajo që mendoj që nuk u përmend dhe është dashtë të përmendet është ky borxh i madh i konsumatorëve pse është ardh kjo situatë atëherë pse nuk u falen atyre që nuk mundën me i pagua edhe kur dihet që ato nuk mund të merren apo të inkasohen kurrë. Pyes se si mundemi ne tani ta shtrenjetojm energjinë edhe për 5%, por duhet që të jemi të kujdesshëm dhe të themi se po shtrenjtohet energjia, por jo për shtresat e varfra pra të behet një ngritje selektive. Pra ju lutemi duhet të jemi të kujdesshëm sepse është shumë e dëmshme të bëjmë lëvizje të pa menduara mirë. Edhe nëse do të behet një ngritje le të behet një ngritje selektive.

**Et'hem Çeku** – theksoj që një çështje që duhet ta ngrinin ne si Komision mendoj që është ajo që të behet ndryshimi i Kodit Penal sepse kemi pasur një rezistencë nga Prokuroria dhe Gjykata, sepse nuk po mundemi me sanksionua vjedhjen e energjisë elektrike si vepër penale. Pasiqë nuk është problemi vetëm tek menaxhmenti sepse ajo mund të eliminohet më lehtësi. Poashtu është problemi edhe tek konsumatorët e mdhej por nuk paraqesin problem aq të madh mirëpo harxhimet apo borxhet e mëdha dhe vjedhja e madhe është tek amvisëria. Prandaj unë them që mos të bëhen gabime që janë bërë më herët. Dhe kërkoj që të thirret një takim edhe nivelin qeveritar edhe donatorët dhe të nxjerrim rekomandime të përbashkëta.

**Ali Hamiti (Kryetar i Bordit të ZRRE-së)** – në përgjigjet e pyetjeve të bëra nga anëtarët e Komisionit, në përgjithësi pohoj se nga anëtarët e Komisionet u vrejten disa kundërthënie sepse po thuhet se deshirojm tarifa të ulëta dhe spo deshirojm tarifa sociale, këto të dyja nuk shkojnë. Pastaj u tha që duhet më investu por spo deshirojm më dhene mjete financiare, sepse nuk bënë me i ngrit çmimet edhe pse janë më të ulëta në regjion. Po të mos ishin subvencionet e qeverisë as kjo gjendje që është sot nuk do të ekzistonte sepse çështja është shumë më multidisiplinare dhe më komplekse se sa që shihet mirëpo nuk mund të shkohet gjithnjë më subvencione të askujt. Prandaj behet rishikimi vjetor dhe tendenca e rritjes së tarifës behet në bazë të çmimit të tregut që ekziston sepse ne nuk mund të caktojmë çmimin e tregut të lirë. Atë që dua të them është që KEK-u nuk e përkrah sistematizimin e kategorive sepse e ka me te lehtë të bëjë inkasimin apo faturimin dhe nuk paraqet tarifën ditë natë. Në metodologjinë tonë tarifore të ZRRE-së

parashihen që veç tjerash të koston reeffektive sepse energjia kushton aq ne duhet ta shesim aq sa kushton e jo pastaj të dalin diferenca në çmim sepse atë dikush duhet më pagu. Mirëpo në jemi të vetëdijshëm që askush nuk mund të kënaqet më rritje të çmimit, sepse është iluzore kjo mirëpo është e domosdoshme të behet kjo rritje sepse është çështje e koston dhe e imponimit të kësaj kostoje.

**Nysret Avdiu (anëtar i Bordit të ZRRE-së)** – theksoj që Kosova është nënshkruese e Traktatit të energjisë dhe ky Traktat është një zgjerim i tregut të energjisë rajonale drejt tregut evropian dhe aty parashihen kushte të caktuara ku kusht themelor është shturja e tarifës, kusht tjetër është që mos më pas subvencione prej një grupi në grupin tjetër mirëpo ne nuk mund ta zbatoj atë sepse nuk kemi mundsi për të cilat u fol këtu. Pra ajo që duhet të them është një tarifë e koston reflektive të shturur. Por një reformim i sektorit pa përkrahje politike nuk mund të realizohet prandaj ne duhet të ballafaqohemi më këtë çështje dhe me integrimin e rajonit. Kështuqë ne jemi të hapur në këtë aspekt dhe presim vërejtjet e të gjithë mekanizmave relevant por edhe rekomandimet e Komisionit tuaj.

#### **Përfundim:**

Komisioni u pajtua që në mbledhjen e ardhme më datë 18.03.2008, të ftohen zv Kryeministri, Ministri për Energji dhe Miniera dhe Ministri për Financa në të cilen do të shqyrtohet strategjia politike e institucioneve përkatëse lidhur me tarifën e energjisë për vitin 2008.

#### **II. Të ndryshme;**

**Kryetarja** – i njoftoj anëtarët e Komisionit për një kërkesë të ART-së e cila ka të bëjë me Strategjinë Kombëtare për Implementimin e FWA ( Fixed Wireless Access). Komisioni u pajtua që kjo temë të trajtohet në njërin nga mbledhjet e ardhshme.

Mbledhja përfundoj në ora 13.

Kryetare e Komisionit;  
Myzejene Selmani